



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**  
**SEKTORI I PROKURIMEVE**

**Durrës, më 28.05.2024**

**PROCESVERBAL**  
**Tipi i kontratës - Punë**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

I mbajtur sot me datë 28.05.2024 në Durrës, nga ana e Njesisë së Prokurimit, ngritur me urdhrin nr. 3329/2 prot., datë 23.05.2024, me qëllim zbardhjen e procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të kërkesave të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit ‘E Hapur’, me të dhënat si më poshtë vijon:

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Rikostruksion rruge në Njësinë Administrative Ishëm”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):** Emërtimi dhe identifikimi i Kodi CPV- Punime ndërtimi për rrugë 45233120-6.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 16.665.708,19 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë shtatëqind e tetë presje nëntëmbëdhjetë) Lek pa TVSH.

**MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS**

**Argumentim:**

Në zbatim të urdhërit të grupit të Specifikimeve nr.82 e nr. 3329 prot., datë 11.03.2024 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përlllogaritjen e fondit Limit për procedurën e prokurimit me objektin e mësipërm”, të planifikuar për t’u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit, dokumentat sipas Buxhetit të Bashkisë, për fondin limit, shqyrtoi dokumentet e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuara nga grupi i punës.

## **PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:**

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga Njësia e Projektit dhe Infrastruktura, objekt i këtij prokurimi.

*Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr. 162 , datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 36.*

## **PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS:**

**Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr.162 date 23.12.2020** “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmime të botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe,

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Në përfundim të punës së grupit u vërejt se:

Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin për projekt zbatimin e objektit: “Rikonstruksion rruge në Njësinë Administrative Ishëm”

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës për prokurimin me titull: “Rikonstruksion rruge në Njësinë Administrative Ishëm” rezultoi të jetë **16.665.708,19 lek neto pa tvsh.**

Mbështetur në rezultatin e sipër nxjerrë, Komisioni **me unanimitet, vendosi:**

Të përcaktojë vlerën limit të kontratës për një shumë prej **16.665.708,19 lek neto pa tvsh.**

Afati i realizimit të punimeve është 23 (njëzet e tre) ditë pune.

Garancia për mbulimin të difekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit, nga ana e firmës të jetë 2 vjet .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

## 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin i ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP-së, i ndryshuar, nenit 26, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme, (sipas shtojcës 7).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 16’000’000 lekë.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

---

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të neneve 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

*Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2024 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrorjnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 8’000’000 Lek, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 32’000’000 lek.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 9.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

*Referuar fondit limit sipas nenin 39 pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

---

**Aftësitë teknike dhe profesionale të tjerat si më poshtë janë hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga:** “Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar:

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP. 1-A Punime gërmimi në tokë;
- NP. 4-A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale;
- N.S. 18-A Punime topogjeodezike;

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të Vendime të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimit nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

**Kategoritë e poshtëshënuara, janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve**

KATEGORIA E	PERSHKRIMI I KATEGORISË	ZËRAT E PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN	NIVELI I KLASIFIKIM	VLERA E PUNIMEVE QË
-------------	-------------------------	--	---------------------	---------------------

KËRKUAR	SIPAS LEGJISLACIONIT TË FUSHËS	NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE	IT I KËRKUAR PËR KATEGORINË RESPEKTIVE	PARASHIKOHE N TË KRYHEN NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE
NP. 1-A	Punime gërmimi në tokë;	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjerësi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet Transport dheu me auto deri 5.0 km Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjerësi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne mjet	A, 0-20 milionë lek	<b>979,249 LEK</b>
NP. 4-A	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale;	-Prishje mur blloqe betony -Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri, t=25 -Shtrese çakelli t=15cm, makadam, perhapur e ngjeshur me makineri -Shtrese stabilizant t=10cm -Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri,per bankinat -Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri -Shtrese binderi me zall lavatrice,6cm,me makineri -Shtrese binderi me zall lavatrice, 3cm, me krah, nga pk,17-19 -Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice,4cm,me mak	A, 21-50 milionë lek	<b>15,686,459.19 LEK</b>
N.S.18-A	Punime topogjeodezike;	Është kërkuar për arësye të zbatimit të rievimeve topografike që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë dhe punimeve topogjeodezike në objekt.		

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

*Për stafin e sipërcituar të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale (diploma e inxhinierëve) ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune. Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 ne DST.*

**2.3.4** Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:



- Inxhinier Gjeodet            1 (një)
- Teknik ndërtimi            1 (një)

*Për stafin e sipërcituar të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale (diploma e inxhinierëve, teknikut të ndërtimit) ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune. Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 ne DST.*

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- Manovratorë                    4 punonjës
- Drejtues Mjeti                3 punonjës
- Punëtorë ndërtimi të thjeshtë    15 punonjës

*Për stafin e sipërcituar të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune. Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 ne DST.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- **Inxhinieri i Ndërtimit**, është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin ndërtimit të trupit të rrugës, si hedhjen e shtresës së çakëllit, stabilizantit si dhe shtresat e tapetit si asfalt dhe binder. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve, konkretisht: çakëll, stabilizant, binder dhe asfalt.
- **Inxhinieri gjeodet**, është kërkuar me qëllim realizimin e rëlevimeve topografike të domosdoshme gjatë zbatimit.
- **Tekniku i Ndërtimit**, është i nevojshëm për ndjekjen nga afër të gjithë punimeve ndërtimore në bazë të zërave të preventivit duke ndjekur me përpikmëri kushtet teknike të zbatimit si dhe është përgjegjës për koordinimin e punës në kantierin e ndërtimit.
- **Manovratorët**, janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve të rënda si eskavatori, rruli, graideri,
- **Drejtuesit e mjetit**, janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamion dhe autobetoniere.

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 25 persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Numri prej 25 punonjës përfshin 15 punëtorë të thjeshtë + 10 personat që janë stafi i kualifikuar i inxhinierëve dhe teknikëve, drejtues mjeti, manovratorë të përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve gjithashtu per llogaritjen e numrit te punonjesve jane marre parasysh kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 ne DST.*

**2.3.7** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji Makinerive	SASIA
Automjete vetshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 3.5-7.5 ton	2 copë
Automjete vetshkarkuese me masë maksimale të autorizuar mbi 18 ton	1 copë
Graider	1 copë
Eskavator me goma	2 copë
Asfaltshtruese	1 copë
Autobot Ujë	1 copë
Rul me vibrim	1 copë

*Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituar të disponojë: Dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Certifikata e Kontrollit Teknik, Certifikata e transportit të malrrave/Liçencë, Foto e mjetit (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të disponojë dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/dhena teknike, ose ekuivalenti i tij/saj). Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Mjetet e mësipërme kërkohen, duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit të kryera gjatë periudhës më të ngarkuar (pikut) duke marrë parasysh gjithashtu edhe kombinimet e mundshme të punes së mjeteve në kantjerin në të cilën është e shpërndarë puna objekt prokurimi.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, ”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

### **2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata:**



- a. ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarde të cilësisë, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- b. ISO 45001: 2018 -Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në vendet e punës, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

## 2.5 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45 Seksioni III VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomike më e favorshme, bazohet **në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave**”

### Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe neni 36, të LPP, si dhe neni 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, me të dhenat e mëposhteme:

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Emri Bashkia Durrës  
Adresa Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës  
Tel/Faks 052 22 23 10  
E-mail [info@durres.gov.al](mailto:info@durres.gov.al)  
Ueb-faqe [www.durres.gov.al](http://www.durres.gov.al)

**2. Lloji i procedurës së prokurimit:** Procedurë e Hapur, Punë.

**3. Numri i referencës së procedurës /Lotit:** REF-06981-05-28-2024.

**4. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër:** “Rikostruksion rruge në Njësinë Administrative Ishëm”.

**5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):** Emërtimi dhe identifikimi i Kodi CPV - Punime ndërtimi për rrugë 45233120-6.

**6. Fondi limit:** 16.665.708,19 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë shtatëqind e tetë presje nëntëmbëdhjetë) Lek pa TVSH.

**7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:** 23 (njëzet e tre) ditë.

**8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:** 13.06.2024, ora 10.00.

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anetarëve të njësive kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP([www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)).

**Njësia e Prokurimit**